



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 44 regjistër (JR)
Datë 11.11.2024

Nr. 23 i vendimit
Datë 04.03.2026

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– shpalli në seancë gjyqësore publike, ditën e mërkurë, datë 04.03.2026, në orën 14:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Griselda Muça, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 44/2024 (JR), që i përket:

ANKUESE: Komisionerja Publike, znj. Irena Nino.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 789, datë 25.07.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Albana Palaj.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi përfaqësuesin e autorizuar të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, z. Adnan Xholi, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 789, datë 25.07.2024 dhe shkarkimin nga detyra të

subjektit të rivlerësimit, dëgjoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Albana Palaj, që përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Albana Palaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit/subjekti”), për shkak të pozicionit të saj si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, aktualisht ndihmëse ligjore në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “AKSIK”), Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), nga Shkolla e Magjistraturës dhe vendosi të përfundojë hetimin kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

2.1. ILDKPKI-ja, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë të subjektit të rivlerësimit, në Aktin e Kontrollit të dërguar në Komision referon: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për pasuritë dhe të ardhurat; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2. AKSIK-ja, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit¹, ka referuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit.*

2.3. KLGj-ja, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi dhe pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka përcjellë pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit². Gjithashtu, Shkolla e Magjistraturës ka dërguar rezultatet e testimit për subjektin e rivlerësimit³, sipas parashikimit të nenit 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 789, datë 25.07.2024, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit

¹ Me nr. {***} prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZh-së nr. {***}, datë 24.10.2023.

² Me nr. {***} prot., datë 22.06.2023.

³ Me nr. {***} prot., datë 23.05.2018.

të rivlerësimit, znj. Albana Palaj. Sipas çështjeve të shqyrtuara për secilin kriter, Komisioni vlerësoi me arsyetimin e përmbledhur si vijon.

i) Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: [...] në lidhje me rubrikën e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk rezultuan problematika, të cilat kanë të bëjnë me deklaram të pamjaftueshëm apo mungesë burimesh të ligjshme të krijimit të tyre, të cilat të jenë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Rezultoi e provuar se pasuritë janë krijuar kohë përpara se subjekti të ushtronte detyrën e ndihmëses ligjore dhe me të ardhurat e bashkëshortit të saj. Subjekti nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit. [...].

ii) Për kriterin e kontrollit të figurës: [...] Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e AKSIK-së dhe informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose që të jetë i përfshirë apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës [...].

iii) Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: [...] Në përmbushje të parashikimit të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në zbatim të nenit 59, pika 1, shkronja “c”, trupi gjykues e konsideron subjektin e rivlerësimit të aftë në kryerjen e funksionit të ndihmëses ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër [...].

III. Shkaqet e ankimit të paraqitura nga Komisionerja Publike

4. Komisionerja Publike Irena Nino (në vijim “Komisionerja Publike”) ushtroi ankim⁴ ndaj vendimit nr. 789, datë 25.07.2024, të Komisionit, duke i kërkuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë ndryshimin e këtij vendimi dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Albana Palaj. Në mënyrë të përmbledhur, shkaqet e ankimit, janë si vijon.

4.1. Subjekti i rivlerësimit, në përfundim të hetimit administrativ, nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar nga Komisioni për mbulimin me burime të ligjshme të pasurive “Godinë e kombinuar 3 kate, dhe tokë me sip. 1.412 m²”, duke u ndodhur në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Lidhur me pasuritë e krijuara nga subjekti i rivlerësimit para fillimit të detyrës, në drejtim të interpretimit të dispozitave ligjore të paketës në drejtësi, lidhur me momentin e krijimit të këtyre pasurive, Kolegji ka një jurisprudencë të konsoliduar dhe të harmonizuar, e cila ka konfirmuar qëndrimin se për vlerësimin e pasurisë, ligji nuk kufizon as kohën as cilësinë që subjektet e rivlerësimit kanë pasur në momentin e krijimit të tyre.

4.2. Lidhur me kursimet cash në shumën 1.000.000 lekë të deklaruar prej subjektit me burim kursimet e akumuluar në llogarinë bankare në Tirana Bank, Komisionerja Publike ndan

⁴ Me nr. {***} prot., datë 30.10.2024.

qëndrim të ndryshëm nga Komisioni. Kursimet në llogarinë bankare në emër të subjektit, nga e cila është tërhequr shuma 1.000.000 lekë që deklarohet prej saj si kursim *cash*, janë krijuar kryesisht në periudhën 2007-2015, për të cilën nga analiza financiare e Komisionit është konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar me burime të ligjshme investimet, shpenzimet dhe kursimet e realizuara në këtë periudhë. Si rrjedhojë, kursimet *cash* të deklaruara në shumën 1.000.000 lekë nuk mbulohej me burime të ligjshme, duke u ndodhur subjekti në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

4.3. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/bashkëshorti nuk kanë arritur të provojnë të kundërtën lidhur me mbulimin me burime të ligjshme të pasurive në pronësi të tyre. Referuar analizës financiare të Komisionit, pamjaftueshmëria e konstatuar para dhe pas fillimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit, në vlerë totale rreth (-) 16.000.000 lekë, tejkalon dhe nuk justifikon në mënyrë objektive masën e proporcionalitetit të zbatuar deri tani nga Kolegji, duke u ndodhur kështu në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

IV. Kundërankimi i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit

5. Subjekti i rivlerësimit depozitoi në Kolegji “*Kundërankim ndaj ankimit të Komisionerit Publik për shfuqizimin e vendimit nr. 789, datë 25.07.2024, të KPK-së*”⁵, me të cilin kundërshtoi ankimin e paraqitur nga Komisionerja Publike për shfuqizimin e vendimit nr. 789, datë 25.07.2024, të Komisionit, që ka vendosur konfirmimin e saj në detyrë. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se vendimi i Komisionit duhet konsideruar i drejtë, i bazuar në prova e në ligj dhe i marrë në respektim të parimit të proporcionalitetit, dhe se kërkesa e Komisioneres për shfuqizimin e tij dhe shkarkimin e saj nga detyra është e pabazuar në ligj e në fakte, si dhe është joproporcionale, duke argumentuar në mënyrë të përmbledhur si vijon.

5.1. Duke referuar në qëndrimin e GjEDNj-së në çështjen *Sevdari kundër Shqipërisë*⁶, si dhe opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar në këtë çështje, subjekti parashtroi se edhe në rastin e saj theksohet nevoja për një vlerësim të balancuar e të drejtë, duke marrë parasysh faktet dhe rrethanat individuale, treguar me prova dhe dëshmi për sakrificat dhe rrethanat e veçanta të punës së saj dhe të bashkëshortit në emigracion. Përpos se e gjithë pasuria është krijuar para periudhës së ushtrimit të funksionit të ndihmësës ligjore, sikundër Komisioni ka vlerësuar, të ardhurat e “pamundura” për t’u dokumentuar në mënyrë të plotë nuk janë më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, pragu i përmendur në nenin 61, pika 1, si kusht për shkarkim. Subjekti ka potencuar se ka përmbushur detyrimin për të deklaruar me saktësi pasuritë e saj, dhe Komisionerja duhet të provojë që ajo ka bërë deklaratë false dhe nuk zotëron burimet e të ardhurave të deklaruara, gjë që nuk e ka provuar, ndaj ankimi i saj nuk mund të mbështetet në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon deklarin e pamjaftueshëm të kriterit të pasurisë.

⁵ Me nr. {***} prot., datë 11.11.2024.

⁶ “Gjykata ka pranuar, gjithashtu, në këtë drejtim se në vlerësimin e përputhshmërisë së zyrtarëve me ligjet kundër korrupsionit mund të jetë legjitime të merren parasysh të ardhurat dhe deklarin e bashkëshortit, partnerit ose anëtarit tjetër të familjes së ngushtë të zyrtarit (shih *Samoylova kundër Ruisë*, nr. 49108/11, paragrafët 85-86, 14 dhjetor 2021). Njëkohësisht, jo çdo problematikë e vogël mospërputhjeje me normat e deklarimit të pasurisë, ose mospërputhje të parëndësishme mes shpenzimeve dhe burimeve të ligjshme, duhet të passjellë masa disiplinore të rënda, siç është shkarkimi nga detyra”.

5.2. Me dokumentacionin e paraqitur - pasqyrat e llogarive të sigurimeve shoqërore (*estratto conto*), në emër të saj, dhe të përditësuara në emër të bashkëshortit (ku figurojnë të ardhura edhe për vitet 2002 dhe 2003 në vlerën 11.652.00 euro), të siguruara me kërkesë të bashkëshortit në datën 13.07.2024 - ka provuar se ajo dhe bashkëshorti kanë punuar në emigracion, pavarësisht se në dokumentacion nuk pasqyrohen të gjitha të ardhurat. Ajo vetë, përpos punëve të ndryshme pranë {***}, provuar me provë shkresore, ka punuar dhe siguruar të ardhura edhe në pastrimin e disa shtëpive, pasi puna në restorante ishte sezonale (maj-tetor), në vitin 2003 ka punuar në restorantin “{***}”, dy turne pa ndërprerje (50 euro/turn), në çdo fundjavë dhe ditë festash. Në rastin e bashkëshortit, i cili ka punuar me kohë të plotë gjatë gjithë vitit kalendarik pranë {***}, për shkak të deklarimeve jo të plota/të pjesshme të punëdhënësve, në dokumentacion nuk pasqyrohet ½ e të ardhurave të realizuara në fakt. Gjithashtu, bashkëshorti ka punuar jashtë 8-orarit të punës, si dhe të shtunave, të dielave, në ditët e festave zyrtare, duke siguruar të ardhura shtesë nga paga edhe mbi 1.000.000 lireta në muaj, ndërkohë shpenzimet javore, kryesisht për fëmijën, pasi gjatë punës pranë {***}, si të gjithë punonjësit e tjerë bashkëshorti dhe ajo (për të muajt maj-tetor) kishin të përfshirë drekën dhe darkën kur punohej me dy turne, mbuloreshin prej bakshisheve që fitonte bashkëshorti si roje parkimi çdo të shtunë e të diel.

5.3. Sikurse ka pohuar/parashtruar në Komision, i qëndron faktit se është në pamundësi objektive për të vërtetuar me dokumentacion ligjor të gjithë të ardhurat e ligjshme të saj dhe të bashkëshortit në emigracion, ku nuk kishin luksin të zgjidhnin punën, por kanë punuar në çdo punë të ndershme që i është ofruar, qoftë me deklaram të pjesshëm apo të padeklaruar, me qëllim për të mbledhur vlera monetare dhe për të investuar në vend. Për të ardhurat nga emigracioni ka arritur të evidentojë se janë frute të një pune të pastër dhe sakrifice të madhe, nuk janë prej aktiviteteve të paligjshme apo korruptive - qëllimi i vërtetë i ligjit të rivlerësimit.

V. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegji

i) Juridiksioni i Kolegjit

6. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

ii) Legjitimimi i ankuesit

7. Komisionerja Publike legjitimohet (*ratione personae*), në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe (*ratione temporis*), pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes

8. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisioneres Publike ndaj vendimit të Komisionit nr. 789, datë 25.07.2024, për subjektin e rivlerësimit, znj. Albana Palaj, u morr në shqyrtim nga trupi gjykues në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve.
9. Për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të institucionit të Komisionerëve Publikë, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe nenit 199, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”) vendosi kalimin procedural nga Komisionerja Publike te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, z. Klodjan Braho, i cili u përfaqësua në këtë gjykim nga prokurori i Prokurorisë së Posaçme, z. Adnan Xholi, sipas tagrave të përfaqësimit të pasqyruara në autorizimin nr. {***} prot., datë 09.02.2026.
10. Në parashtrimet e tij përpara trupit gjykues, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme deklaroi se u qëndron shkaqeve të ankimit të ushtruar nga Komisionerja Publike kundër vendimit objekt shqyrtimi, kërkoi marrjen në shqyrtim të tyre prej Kolegjit, ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 789, datë 25.07.2024 dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Albana Palaj.
11. Subjekti i rivlerësimit, me të njëjtat argumente si në kundërankim, prapësoi shkaqet e ankimit duke deklaruar se ankimi është joobjektiv, i pabazuar në ligj e në prova dhe, si i tillë, nuk arrin të rrëzojë vendimin e konfirmimit të Komisionit, i cili është i drejtë, proporcional, i bazuar në një analizë të plotë financiare dhe në rrethanat e çështjes.
12. Në përfundim, trupi gjykues, pasi dëgjoi pretendimet e palëve, vendosi të mbyllë hetimin gjyqësor dhe ftoi palët për të dhënë konkluzionet përfundimtare. Gjatë paraqitjes së konkluzioneve përfundimtare të çështjes, palët i qëndruan kërkimeve të tyre si më sipër. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, i përfaqësuar nga prokurori Adnan Xholi, u shpreh se pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjithë kërkimet dhe prapësimet e palëve, vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme pasuritë e deklaruar në deklaratën *vetting*, duke u ndodhur kështu në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 789, datë 25.07.2024, të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Albana Palaj. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se mungon çdo lidhje logjike dhe faktike midis ushtrimit të funksionit dhe pasurive (që figurojnë në emër të bashkëshortit) të krijuara kryesisht përpara ushtrimit të funksionit prej saj, me burime të lidhura me emigracionin dhe punën e ndershme familjare për periudha të gjata kohore (bashkëshorti mbi 20 vite dhe ajo rreth 7 vite), se nuk ekziston asnjë indikator që të mbështesë përfundimin se burimet janë të paligjshme dhe të lidhura me funksionin, çka bën edhe më të domosdoshëm peshimin proporcional të gjetjeve financiare, dhe jo lexim mekanik të analizës financiare. Duke potencuar se nuk mund të penalizohet për çdo element të një periudhë të gjatë emigracioni (informaliteti), kur mungon keqbesimi dhe elementet e paligjshmërisë, subjekti kërkoi rrëzimin e ankimit, si të pambështetur në ligj e në prova dhe lënien në fuqi të vendimit objekt gjykimi.
13. Trupi gjykues, pasi analizoi pretendimet e ngritura nga Komisionerja Publike, në ankim, dhe ato të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në parashtrime dhe konkluzione përfundimtare, të

cilat mbështetën plotësisht shkaqet e ankimit, prapësimet e subjektit të rivlerësimit në kundërankim, gjatë gjykimit dhe në konkluzione përfundimtare, si dhe pasi shqyrtoi provat shkresore të administruara në dosjen gjyqësore nën dritën e kuadrit ligjor të zbatueshëm, arriti në përfundimet e mëposhtme.

Vlerësimi i shkaqeve të ankimit të Komisioneres Publike lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

14. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme pretendoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme pasuritë e deklaruara në deklaratën *vetting*: *godinë e kombinuar 3 kate dhe tokë me sip. 1.412 m²* dhe likuiditetet *cash* në vlerën 1.000.000 lekë, dhe se referuar analizës financiare, pamjaftueshmëria e konstatuar, në total në vlerën rreth (-) 16.000.000 lekë, nuk justifikon në mënyrë objektive masën e proporcionalitetit të zbatuar deri tani nga Kolegji.
15. Trupi gjykues, në funksion të dhënies përgjigje të shkaqeve të ankimit dhe kërkimit përfundimtar të ankuesit, vlerëson të parashtrrojë fillimisht disa konsiderata që i referohen situatës faktike të adresuar për kontroll.
16. ***Pasuria “Godinë e kombinuar 3 kate dhe tokë me sip. 1.412 m²”***

16.1. Në deklaratën *vetting*, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit deklaroi: *Tokë me sipërfaqe 1.412 m², blerë sipas aktit të shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.05.2002, certifikuar nga ZVRPP-ja Shkodër, datë lëshimi 21.05.2002. Vlera: 100.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Tek pasuria 1.412 m², ndërtuar godinë e kombinuar në tre kate për banim dhe aktivitet (380 m² banim dhe 223,2 m² për aktivitet), e legalizuar dhe certifikuar, realizuar me punonjës të palicencuar (jo firmë ndërtimi, prandaj edhe shpenzimet deklarohen pak a shumë në sajë të shënimeve individuale.) Vlera: 15.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100%⁷.*

16.2. Gjatë hetimit administrativ⁸, lidhur me burimin e krijimit të pasurisë, subjekti deklaroi se: *“Unë dhe bashkëshorti im të gjithë paratë e kursyera në emigrim i kemi transportuar nga Italia drejt Shqipërisë në cash, në periudha të ndryshme që nga viti i parë i emigrimit (viti 1996) [...] shpesh herë kemi punuar dhe me dy turne, nuk kemi njohur festa, pushime verore apo fundjava, pasi qëllimi ynë ishte të mbledhim paratë për tu kthyer dhe për të investuar në vendin tonë. Investimet tona kanë filluar që në vitin 1996, kur është blerë apartamenti në Shkodër dhe më pas me blerjen e tokës në Njësinë Administrative Bërdicë (blerë dy herësh në vitin 2002 dhe 2003), mbi të cilën kemi vijuar punimet fillimisht për një objekt pune (sot shërben si garazh*

⁷ Me deklaratën *vetting* është përcjellë dokumentacion, nga i cili rezulton se pasuria numër {***} (tokë + arë) është regjistruar në emër të F. E. (bashkëshorti i subjektit) në datën 21.04.2002 (kartelë e pasurisë së paluajtshme); shkresë/informacion mbi pasurinë, konfirmohet se shtetasi F. E. ka të regjistruar pasurinë: arë + truall me sipërfaqe 1.412 m² nga të cilat 700 m² janë truall, nga të cilat 365,2 m² janë ndërtesë ndodhur në z.k. {***}, nr. pasurie {***}, vol. {***}, fq. {***}, me adresë fshati Bërdicë e Sipërme, Shkodër; certifikatë pasurie lëshuar në datën 08.09.2015, për pasurinë si më lart dhe leje legalizimi në emër të F. E. nr. {***}, datë 15.10.2014, për “Godinë e kombinuar 3 kate” me sipërfaqe banimi 380 m² + 223,2 m², për aktivitet.

⁸ Pyetësori standard, pyetja nr. 17 “A keni marrë nga jashtë Shqipërisë, apo keni nxjerrë jashtë Shqipërisë të holla cash në cilëndo shumë, mbi shumën e barasvlefshme me 500 euro, nëse po, kur, në çfarë shume dhe nga kush apo drejt cilit shtete? Cili ka qenë qëllimi i transfertave në të holla cash? Lutemi paraqisni dokumentacion provues”

për mjetet e firmës) dhe mbi të është ngritur banesa jonë private, punime të cilat kanë filluar që pa u kthyer nga Italia [...]” .

16.3. Lidhur me të ardhurat e siguruara nga puna emigracion, subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti, në deklaratën *vetting*⁹, deklarojnë si vijon.

- Subjekti deklaron: *01.11.1999-30.08.2004, në emigracion me dokumentacion qëndrimi në shtetin italian. Një pjesë e vogël e punës e dokumentuar sipas busta pagave, ndërsa pjesa më e madhe e saj është e padeklaruar (pjatallarëse, ndihmës kameriere, ndihmës kuzhinierë pranë agroturismo {***}, restorant {***}, në {***}, Romë-Itali), prandaj edhe përshkrimi i të ardhurave përafërsisht është: 50.000 euro.*

- Personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit deklaron: *1991-1994, emigruar pa dokumentacion qëndrimi në Greqi, prandaj dhe fitimi nuk mund të provohet me dokumentacion. Shuma e të ardhurave neto 2.000.000 lekë. Në vitin 1996 emigruar në Itali dhe prej datës 28.08.1996 e në vijim emigrant me dokumentacion të rregullt qëndrimi në Itali. (fitimi sipas punës së deklaruar nga data 01.06.1997-13.03.2015, sipas ekstraktit të llogarive të pensioneve të Sigurimeve Shoqërore (INPS datë 25.10.2016). Shuma e të ardhurave neto 146.384,4 euro.*

Gjatë kësaj periudhe është kryer punë e pa dokumentuar (quajtur ndryshe në të zezë), punë të ndryshme në ndërtim, mirëmbajtje kopshti, shërbime si shofer, shërbime veterinarie dhe ky fitim mund të deklarohet me afërsi në vlerën: 150.000 euro.

16.4. Komisioni, lidhur me pasurinë “*godinë e kombinuar në tre kate për banim dhe aktivitet (380 m² banim dhe 223,2 m² për aktivitet)*”, ka konsideruar: (i) koston e investimit të deklaruar në deklaratën *vetting* prej 15.000.000 lekësh, pasi referuar deklarimit të subjektit se punimet në objekt janë kryer nga punonjës të palicencuar, sipas metodologjisë në raste të ngjashme, duke aplikuar zbritjen e vlerës së TVSH-së, fitimit të parashikuar, etj., i ka rezultuar vlerë e ndërtimit të objektit rreth vlerës (madje më e vogël) së deklaruar nga subjekti në deklaratën *vetting*¹⁰; (ii) kryerjen e punimeve të ndërtimit përgjatë periudhës 2005-2014, duke vlerësuar se ndërtimi i banesës ka nisur pas kthimit të subjektit në Shqipëri (deklaruar fundviti 2004, pra, fillimi i vitit 2005), dhe se deri në datën e aplikimit për legalizim, datë 17.07.2013, objekti ishte ende i papërfunduar (ngritur karabinaja dhe muratura e tij, sipas fotove të objektit bashkëlidhur me përgjigjen e AShK-së Shkodër); (iii) vlerën prej 15.000.000 lekësh e ka shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme gjatë periudhës 2005-2014, për sa nga hetimi nuk u arrit të përcaktohej saktësisht koha e punimeve dhe sa punime janë kryer çdo vit. Në përfundim të hetimit administrativ kryesisht, lidhur me mundësinë e krijimit me të ardhura të ligjshme të këtyre pasurive të krijuara pjesërisht gjatë kohës që subjekti ka qenë familjarisht në emigracion (blerja e tokës) dhe pas kthimit të saj së bashku me fëmijët në Shqipëri, ndërsa bashkëshorti ka vijuar në emigracion (ndërtimi i godinës), subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë

⁹ *Bashkëlidhur deklaratës vetting janë depozituar: (i) kopje listëpagesë për subjektin për periudhën dhjetor 2001 - nëntor 2002, me vlerë totale 8.957 euro; (ii) kopje vërtetimi e INPS për bashkëshortin e subjektit, nga rezulton se për periudhën 30.11.1997- 13.03.2015 ka përfutuar të ardhura nga punësimi në Itali në vlerën totale 146.384 euro.*

¹⁰ *Në vendimin objekt shqyrtimi, Komisioni evidenton se referuar koston së ndërtimit nga EKB-ja, të dhënat i referohen qytetit të Shkodrës dhe jo zonave rreth saj, kosto e të cilave mund të jetë më e vogël nga kosto e qytetit të Shkodrës.*

rezultuar me pamundësi financiare në vlerën (-) 8.238.964 lekë (100.000 lekë blerja e truallit + 8.138.964 lekë ndërtimi i objektit).

16.5. Në vlerësim edhe të shpjegimeve të subjektit në përgjigje të barrës së provës¹¹, e cila me parashtrimet ka depozituar pasqyrë të llogarisë së sigurimeve shoqërore në emër të bashkëshortit, e përditësuar dhe pasqyra e llogarisë së sigurimeve shoqërore në emrin e subjektit¹², si dhe ka pretenduar pamundësinë objektive për të provuar të ardhurat *de facto* të deklaruara, nga puna në emigracion e saj dhe e bashkëshortit, Komisioni ka konkluduar se: [..] pasuritë si më lart janë krijuar para marrjes së detyrës nga subjekti i rivlerësimit dhe se, për shkak të kohës së gjatë të krijimit të pasurisë, periudhës së gjatë të krijimit të të ardhurave të përdorura për investimin në pasuri, faktit të njohur të impaktit të remitancave nga emigrantët në ekonominë e vendit dhe të të ardhurave informale të përfituara prej tyre gjatë kësaj periudhe, çmon se pamundësia financiare e rezultuar nuk duhet të vlerësohet penalizuese në procesin e rivlerësimit të subjektit, pavarësisht vlerës së saj. Këto fakte do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit. [...].

16.6. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, sikundër edhe Komisionerja Publike, në ankim, duke sjellë në vëmendje të Kolegjit se lidhur me pasuritë e krijuara nga subjekti i rivlerësimit para fillimit të detyrës, në kontekstin e momentit të krijimit të tyre, ka një jurisprudencë të konsoliduar dhe të harmonizuar, e cila ka konfirmuar qëndrimin se *për vlerësimin e pasurisë, ligji nuk kufizon as kohën as cilësinë që subjektet e rivlerësimit kanë pasur në momentin e krijimit të tyre*, pretendoi se subjekti i rivlerësimit, edhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar nga Komisioni për mbulimin me burime të ligjshme të pasurive “*Godinë e kombinuar 3 kate dhe tokë me sipërfaqe 1.412 m²*”, duke u ndodhur në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

16.7. Subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit u shpreh se i qëndron pohimeve/sqarimeve të dhëna se parimi se *ligji nuk kufizon as kohën e krijimit të pasurisë*, nuk do të thotë që çdo pasuri e krijuar para detyrës trajtohet me të njëjtën peshë si pasuritë e krijuara gjatë ushtrimit të saj. *Pamundësia objektive* për të vërtetuar me dokumentacion ligjor të gjithë të ardhurat *e ligjshme* të saj dhe të bashkëshortit në emigracion, fryt i një punë të pastër, të stërmundueshme, të një sakrifice të madhe -*çmim i skllavërisë për të cilën nuk paguheshin taksa e TVSH*, nuk mund të barazohet automatikisht me “*deklarim të pamjaftueshëm*”, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe “*informaliteti*” i titulluar prej saj, “*punë në të zezë*”, nuk mund të barazohet me burim të paligjshëm.

16.8. Trupi gjykues, *së pari*, nga aktet në dosje, konstaton se subjekti dhe bashkëshorti i saj provojnë qëndrimin në Itali dhe marrëdhëniet e punës, veçanërisht bashkëshorti, në një marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe konsistente, si dhe konstaton se provohen një pjesë e të

¹¹ Me raportin për rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se duket se kjo pasuri është krijuar para marrjes së detyrës nga subjekti i rivlerësimit, dhe ka kaluar barrë prove: duket se, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk kanë pasur mundësi të krijojnë pasurinë me të ardhura të ligjshme, duke rezultuar me pamundësi financiare prej (-) 8.238.964 lekësh (100.000 lekë blerja e truallit + 8.138.964 lekë ndërtimi i objektit). Analiza financiare për blerjen e truallit është bërë kumulative për periudhën 1997-21.04.2002, dhe për ndërtimin e objektit kumulative për periudhën 2005-2014.

¹²Sipas shpjegimeve të subjektit, dokumentacioni është siguruar me kërkesë të bashkëshortit F. E. (me e-mail) më datë 13.07.2024.

ardhurave të deklaruara me dokumentacion, sipas së cilit, subjekti në shumën 8.956 euro dhe bashkëshorti në shumën 146.384 euro. Nga të dhënat e dokumentacionit të administruar - *pasqyrës së kontributeve (contribute utili pensione)* - konstatohen deklarime me ditë apo javë pune, nga të cilat rezulton në total, një periudhë punësimi e pakët për një familje që duhet të përballonte jetesën në Itali, përpos qëllimit për të krijuar kursime për t'i investuar në Shqipëri, sikundër provohet se ka ndodhur. Këto rrethana faktike bëjnë bindës pretendimin e subjektit për deklarime të pjesshme nga punëdhënësit, në favor të interesit për të paguar më pak kontribute. Pavarësisht sa më sipër, edhe në kontekst të këtij opsioni, si një realiteti i njohur i vështirësive me të cilat janë përballur emigrantët shqiptarë, të ardhurat e deklaruara/pretenduar nga subjekti nga puna në emigracion, të cilat nuk kalojnë kriterin kushtetues të së ardhurës së ligjshme, nuk mund të konsiderohen si të tilla në analizën financiare. Për shkak të mungesës së provueshmërisë së një pjese të të ardhurave prej emigracionit të subjektit dhe bashkëshortit të saj, në kuptim të standardit të së ardhurës së ligjshme, sipas parashikimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, konfirmohet pamjaftueshmëria financiare për krijimin e këtyre pasurive në vlerën prej (-) 8.188.234 lekësh. Për rrjedhojë, trupi gjyqës konstaton se pretendimi i ankuesit se subjekti dhe bashkëshorti i saj gjenden në kushtet e një balance negative për të justifikuar krijimin e pasurisë “*godinë e kombinuar 3 kate, dhe tokë me sip. 1.412 m²*, të ndodhur në Bërdicë e Madhe, Shkodër, është i drejtë dhe i bazuar.

17. Pasuria “likuiditete cash në vlerën 1.000.000 lekë”

17.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti deklaroi gjendje cash në banesë, tërhequr pranë Tirana Bank, nga llogaria IBAN {***}, në vlerën 1.000.000 lekë.

17.2. Komisioni, duke qenë se nga hetimi administrativ ka rezultuar se në datën 13.01.2016, subjekti ka tërhequr nga llogaria e saj e pagave pranë Tirana Bank shumën prej 1.000.000 lekësh dhe në datën 29.12.2016 ka tërhequr edhe një shumë tjetër prej 1.000.000 lekësh, ka konstatuar se burimi i krijimit të këtyre shumave është krijuar nga kreditimi i të ardhurave të pagës së subjektit të akumuluar përgjatë disa viteve, ka konkluduar se gjendja *cash* e kursimeve është krijuar me burime të ligjshme dhe se lidhur me këtë pasuri nuk konstatohen problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

17.3. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, sikundër Komisionerja Publike në ankim, sjell në pah se referuar akteve të përcjella nga Tirana Bank të administruar në dosje¹³, rezulton se kursimet e akumuluar në llogarinë bankare në emër të subjektit, që në vijim janë deklaruar si burim krijimi për kursimet *cash*, janë krijuar kryesisht në periudhën 2007-2015, periudhë për të cilën nga analiza financiare e Komisionit është konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar me burime të ligjshme investimet, shpenzimet dhe kursimet e realizuara. Për rrjedhojë, sipas ankuesit, edhe kursimet *cash* në shumën 1.000.000 lekë nuk mbulojnë me burime të ligjshme, duke u ndodhur subjekti në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

17.4. Subjekti pretendon se shuma prej 1.000.000 lekësh ka burime të qarta nga të ardhurat e saj të ligjshme nga paga, të cilat janë të evidentuara dhe të verifikueshme nga veprimet bankare,

¹³ Dokumentacioni i përcjellë nga Tirana Bank me shkresën nr. {***} prot., datë 02.08.2021.

prandaj ky shkak ankimi është i pabazuar në prova dhe nuk qëndron në përputhje me faktet, dhe se rezultati negativ i analizës financiare, një instrument llogaritës, që vjen nga mungesa e dokumentimit të të ardhurave, nuk do të thotë automatikisht se likuiditetet *cash* të deklaruara janë të paligjshme.

17.5. Trupi gjykues, *së pari*, nga aktet në dosjen gjyqësore, konstaton se subjekti ka hapur llogari pranë Tirana Bank në vitin 2005, ku për çdo muaj deri në dhjetor 2016 janë kredituar pagat e saj. Kjo llogari bankare, e furnizuar vetëm me të ardhurat e subjektit nga paga dhe interesat, si rezultat i mostërheqjes së shumave të kredituara e të akumuluar vit pas viti, në datën 31.12.2015 ka pasur gjendje kreditore në shumën 2.218.943 lekë. *Së dyti*, sa i përket likuiditeteve *cash* në vlerën 1.000.000 lekë, të deklaruara në deklaratën *vetting*, për krijimin e të cilave, ankuesi pretendon se subjekti nuk ka burime të ligjshme, trupi gjykues ndan qëndrim të ndryshëm, duke gjetur të drejtë konkluzionin e Komisionit lidhur me to. Në këtë analizë, vlerësohet të evidentohet se burimi i deklaruar prej subjektit të rivlerësimit për krijimin e tyre, si të ardhura nga paga, pasi është verifikuar edhe prej Njësisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, ka rezultuar i saktë dhe i vërtetë. Nga dokumentacioni bankar i administruar në Komision, rezulton se kreditimet ndër vite të pagës janë akumuluar në llogarinë bankare të subjektit në Tirana Bank, kryesisht në periudhën 2007-2015. Nga kjo llogari bankare, e furnizuar vetëm prej pagave të subjektit dhe interesave, gjatë vitit 2016 subjekti ka kryer disa tërheqje¹⁴, në total në shumën prej 2.700.000 lekësh, prej të cilave shuma e fundit prej 1.000.000 lekësh është tërhequr në dhjetor 2016 dhe është deklaruar më pas gjendje *cash* në banesë në deklaratën *vetting*. Kjo pasuri, e deklaruar me burim të ardhurat nga paga, ka rezultuar të jetë krijuar pikërisht në këtë formë dhe nëpërmjet të ardhurave të ligjshme. Analiza financiare, e cila rezulton negative për subjektin edhe në këto vite, është ndikuar në rezultatin e saj edhe nga fakti që këto likuiditete, të cilat kanë qëndruar gjendje në llogarinë bankare janë pozicionuar në zërin e pasurive të subjektit. Kjo balancë negative e krijuar dhe evidentuar prej Komisionit, afekton të gjitha pasuritë dhe shpenzimet e tjera të subjektit, por jo burimin e krijimit të gjendjes *cash*, që vjen drejtpërdrejtë nga të ardhura të ligjshme e të dokumentuara. Për pasojë, pretendimet e ankuesit lidhur me burimin e kësaj pasurie u konsideruan të pabazuara.

18. Lidhur me analizën financiare të Komisionit

18.1. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, pas përfshirjes në analizën financiare të të ardhurave nga puna në emigracion, sipas vërtetimeve të përcjella me prapësime prej subjektit, ka konkluduar se analiza financiare rezulton me balancë negative: (i) në shumën (-) 15.444.142 lekë për periudhën 1997-maj 2015, përpara fillimit të detyrës prej subjektit, (*përfshirë edhe pamundësinë financiare në shumën prej (-) 8.238.964 lekësh për ndërtimin e godinës 3 kate dhe blerjen e tokës me sip. 1.412 m²*); dhe (ii) në shumën (-) 546.547 lekë për periudhën qershor 2015-2016, pas fillimit të detyrës prej subjektit.

18.2. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, sikundër Komisionerja Publike, në ankim, pasi pasqyron disa prej pasurive të deklaruara në deklaratën *vetting* nga subjekti dhe personi i

¹⁴ Në datën 13.01.2016 ka tërhequr shumën 1.000.000 lekë, me përshkrimin “pagë Shkodër”; në datën 15.02.2016 ka tërhequr shumën 400.000 lekë, me përshkrimin “paga Shkodër”; në datën 15.07.2016 ka tërhequr shumën 300.000 lekë, me përshkrimin “kursime paga Shkodër”; në datën 29.12.2016 ka tërhequr shumën 1.000.000 lekë, me përshkrimin “kursime Shkodër”.

lidhur/bashkëshorti¹⁵, referuar analizës financiare të Komisionit, vlerëson se pamjaftueshmëria e konstatuar për periudhën para dhe pas fillimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit, që në total rezulton në vlerën rreth (-) 16.000.000 lekë, tejkalon dhe nuk justifikon në mënyrë objektive masën e proporcionalitetit të zbatuar deri tani nga Kolegji i Posaçëm i Apelit e, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme pasuritë e deklaruara në deklaratën *vetting*, duke u ndodhur kështu në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

18.3. Subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit pretendoi se qëndrimi i ankuesit e trajton analizën financiare si provë përfundimtare dhe e shkëput atë nga konteksti faktik dhe proporcionaliteti. Sipas saj, gjatë hetimit administrativ dhe në seancën dëgjimore në Komision ka paraqitur prapësime të detajuara dhe prova në masën e mundshme objektivisht për periudhat e emigracionit, duke identifikuar burimet e të ardhurave, periudhat e punësimit, subjektet ku është ushtruar aktiviteti, si dhe dokumentacion mbështetës (dokumentacioni i kontributeve shoqërore/ INPS, deklaratimet për periudhat e emigracionit dhe shpjegimet mbi natyrën e punës informale). Për pasojë, ankimi nuk mbështetet mbi mungesë transparence apo mungesë bashkëpunimi nga ana e saj, por mbi synimin që rezultati negativ të ketë efekt automatik, pa referuar elemente faktike që të rrëzojnë arsyetimin e Komisionit, duke mbetur në nivel të përgjithshëm, dhe duke u mbështetur kryesisht në lexim formal, “mekanik”, të analizës financiare.

18.4. Lidhur me analizën financiare të Komisionit, sipas së cilës për periudhën para fillimit të detyrës prej subjektit, për të dhe personin e lidhur rezulton balancë negative prej (-) 15.444.142 lekësh, dhe për periudhën në detyrë rezulton balancë negative prej (-) 546.547 lekësh, trupi gjykues, duke evidentuar se totali i të ardhurave nga emigracioni të dokumentuara të subjektit dhe të bashkëshortit përbëjnë 49.76% të totalit të të ardhurave të deklaruara me këtë burim në deklaratën *vetting*¹⁶, konstaton dhe vlerëson si vijon.

18.4.1. Për periudhën 1997-2004, që i korrespondon periudhës kur subjekti ka qenë në emigracion në Itali, në analizën financiare të Komisionit, balanca negative rezulton në vlerën prej (-) 7.255.908 lekësh, pasi në të pasqyrohen të ardhura në vlerën 7.214.874 lekë, shpenzime të jetesës në vlerën 14.070.782 lekë dhe pasuri e krijuar në vlerën 400.000 lekë. Pasuria e krijuar në këtë periudhë konsiston në blerjen e dy pasurive të llojit tokë arë, përkatësisht në vitet 2002 dhe 2003, respektivisht në shumat 100.000 lekë dhe 300.000 lekë. Në këndvështrim të vlerave mbi të cilat bazohet kjo analizë, *së pari*, evidentohet qartë se vlera e pasurive të

¹⁵ Pasuri të deklaruara nga subjekti: (i) automjet “Mercedes, Tip Class A170CDI”, viti i prodhimit 2001, me targa {***}. Burimi i krijimit: I blerë cash në Itali, më datë 20.12.2006, nuk disponohet dokumenti përkatës, vetëm dokumenti i pronësisë mbi automjetin. Vlera: 5.000 euro. Pjesa takuese: 100%. Pasuri të deklaruara nga bashkëshorti i subjektit: (i) tokë (arë) me sipërfaqe 600 m², blerë sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.05.2002, certifikuar nga ZVRPP-ja Shkodër, datë lëshimi 20.03.2003. Vlera: 300.000 lekë. Pjesë takuese: 100%; (ii) automjet fugon (9+1), marka Ford, me targë {***}, blerë cash në Itali, për përdorim vetjak. (disponon certifikatën e pronësisë, datë 07.04.2009, por jo një kontratë shitblerje). Vlera: 8.000 euro. Pjesa takuese: 100%.

¹⁶ Të ardhura nga emigracioni të cilat nuk provohen me dokumentacion ligjor, të cilat nuk janë përlllogaritur në analizën financiare rezultojnë për subjektin në shumën 41.043 euro, dhe për personin e lidhur/bashkëshortin në shumën 2.000.000 lekë (të deklaruara nga puna në Greqi) dhe 150.000 euro (të deklaruara nga puna në emigracion në Itali).

krijuara përgjatë kësaj periudhe është ndjeshëm më e vogël se vlera e shpenzimeve të jetesës e, për rrjedhojë, në mënyrë logjike, deduktohet se balanca negative që vjen si diferencë mes vlerës së të ardhurave me vlerën e shpenzimeve [7.214.874 lekë - 14.070.782 lekë], i atribuohet pothuaj krejtësisht shpenzimeve të jetesës. *Së dyti*, shpenzimet e jetesës, të përlllogaritura sipas të dhënave të EUROSTAT-it, janë pothuaj sa dyfishi i të ardhurave të dokumentuara për subjektin në këtë periudhë, raport i cili vë në diskutim vlerën reale të të ardhurave të krijuar nga punësimi. *Së treti*, konsideruar se vlera e pasurive është shumë herë më e vogël se vlera e të ardhurave (përbën rreth 5.54% të tyre), balanca negative, pavarësisht vlerës jo të pakonsiderueshme të saj, nuk mund të mbështesë në mënyrë objektive konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pamjaftueshmëri financiare për krijimin e dy pasurive të sipërcituara, njëra prej të cilave tokë arë me sipërfaqe 600 m² e pashfrytëzuar. Për këto arsye, rrethanat në të cilat subjekti dhe familja e saj kanë përballuar jetesën si emigrantë në vitet 1997-2004 vlerësohen se i nuk i përkasin kontekstit dhe qëllimit të procesit të rivlerësimit. Në vijim të këtij arsyetimi, balanca negative prej (-) 7.255.908 lekësh, e cila i atribuohet shpenzimeve për jetesë të subjektit dhe familjes në vitet 1997-2004, gjendet parelevancë prej trupit gjykues, për vlerësimin e kriterit të pasurisë. Për pasojë, trupi gjykues vlerësoi të mos e konsiderojë këtë balancë negative në vlerësimin e kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit në analogji edhe me rastet tjera të gjykuara më parë¹⁷.

18.4.2. Për periudhën 2005-15.06.2015, që i korrespondon kohës përpara fillimit të detyrës prej subjektit, kur kjo e fundit ka qenë në Shqipëri, ndërsa bashkëshorti ka vijuar në emigracion, dhe për periudhën 16.06.2015-2016, pas marrjes së detyrës prej subjektit, referuar analizës financiare të Komisionit, balancat negative rezultojnë respektivisht në vlerat prej (-) 8.188.234 lekësh dhe (-) 546.547 lekësh, të cilat janë ato që iu nënshtruan analizës në vijim. Trupi gjykues i mori në shqyrtim këto balanca negative duke integruar në analizën e vlerësimit të tyre të dy shkaqet a ankimit, që lidhen me pasurinë godinë tre kate dhe analizën financiare, duke qenë se balanca negative e konsiderueshme në analizën financiare, sipas arsyetimit të bërë më lart, mbetet vetëm ajo që i përket viteve 2005-2015, në të cilat përfshihen të gjitha pasuritë e krijuara nga subjekti dhe personi i lidhur, bashkëshorti, përgjatë kësaj periudhe.

19. Lidhur me zbatimin e parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit

19.1. Në këndvështrim të situatës faktike të përshkruar më lart, trupi gjykues mori në shqyrtim shkakun ankimor se balanca negative e konstatuar, për kriterin e vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, nuk lejon zbatimin e parimit të proporcionalitetit dhe, në këtë rast, subjekti gjendet në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

19.2. Trupi gjykues analizoi një sërë rrethanash lidhur me përcaktimin e peshës që duhet të ketë balanca negative e krijuar më lart, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, duke nisur analizën *së pari*, me faktin se të gjitha pasuritë e krijuara dhe të deklaruar në deklaratën *vetting* janë krijuar para se subjekti i rivlerësimit të merrte detyrën e ndihmës ligjore në qershor të vitit 2015.

19.3. *Së dyti*, të gjitha pasuritë e deklaruar në deklaratën *vetting* me burim të ardhurat nga emigracioni kanë ekzistuar objektivisht në mënyrë të trupëzuar, shumë kohë para se subjekti të

¹⁷ Shih vendimin e Kolegjit nr. 22/2025 (JR).

emërohej në detyrë, konkretisht: (i) tokë arë e ndodhur në Bërdicë të Madhe, Shkodër, krijuar në vitet 2002 dhe 2003; (ii) godinë tre kate, ndërtim informal i realizuar përgjatë periudhës 2004-2014, e vetëdeklaruar prej bashkëshortit pranë ALUIZNI-t më 17.07.2013; (iii) automjet tip “Mercedes Benz”, i blerë në vitin 2006, në Itali; (iv) automjet tip “Ford” i blerë në vitin 2009, në Itali. Krijimi i tyre në kohë përpara emërimit të subjektit në detyrën e ndihmësës ligjore shkëput çdo dyshim për ndonjë ndikim të detyrës së saj në krijimin e tyre, qoftë edhe indirekt.

19.4. Së treti, të ardhurat e deklaruara si burim për krijimin e pasurive, vijnë nga punësimi në emigracion në Itali konkretisht, subjekti figuron se ka jetuar duke qenë në marrëdhënie pune për një periudhë prej 5 vitesh (1999-2004) dhe bashkëshorti prej 19 vitesh (1996-2015), të pajisur me leje qëndrimi. Përgjatë periudhave të sipërcituara të qëndrimit në Itali rezulton se ata kanë përfituar edhe të ardhura të dokumentuara, bashkëshorti në shumën prej 146.384 eurosh dhe subjekti në shumën prej 8.956 euro, fakt që tregon se marrëdhënia e punësimit, veçanërisht për bashkëshortin ka qenë e vazhdueshme dhe konsistente në krijimin e të ardhurave.

19.5. Së katërti, pasuritë janë krijuar në të njëjtën kohë me krijimin e të ardhurave. Nga analizimi i dokumentacionit në fashikullin e Komisionit, për subjektin dhe bashkëshortin, nuk rezulton të jenë deklaruar krijime kursimesh në *cash* në vite dhe përdorim të tyre për krijimin e pasurive, veçanërisht të mbartura dhe përdorura në periudhën kohore pas kthimit nga emigracioni. Në këto kushte, trupi gjykues krijon bindjen se të ardhurat vijnë pikërisht nga burimet e deklaruara dhe janë investuar në pasuritë objekt kontrolli.

19.6. Së pesti, subjekti ka qenë konsistente dhe e sinqertë në lidhje me deklarin e tyre. Ajo ka deklaruar në deklaratën *vetting*, dhe ka pohuar gjatë gjithë procesit të saj të rivlerësimit, se të ardhurat vijnë nga emigracioni dhe një pjesë e tyre janë krijuar në informalitet, duke përshkruar me detaje punët e kryera, si dhe subjektet pranë të cilëve ata kanë qenë punësuar. Informaliteti nuk ka qenë një zgjedhje e subjektit dhe e bashkëshortit të saj, por një rrethanë e imponuar prej punëdhënësit dhe statusit të emigrantit, të cilët natyrshëm kanë prodhuar diskriminime në tregun e punës. Thënë ndryshe, të ardhurat që janë krijuar janë përdorur si për të jetuar, ashtu dhe për të krijuar pasuritë, për të cilat investimet nuk kanë vijuar të ndodhin më pas marrjes së detyrës prej subjektit.

19.7. Së gjashti, ndryshe nga raste të tjera të ngjashme të gjykuara në Kolegj¹⁸, të ardhurat e dokumentuara nga emigracioni arrijnë të justifikojnë krijimin e pasurive, nëse do të kishim një vlerësim në total të tyre.

19.8. Së shtati, situata e mësipërme vlerësohet edhe në këndvështrim të detyrës funksionale që ushtron subjekti i rivlerësimit, atë të ndihmësës ligjore. Trupi gjykues vlerëson se standardi i nivelit të besueshëm për pasurinë për këtë kategori subjektësh nuk orientohet të jetë i njëjtë me atë të përdorur për magjistratët, për shkak të faktit se atyre u mungojnë funksionet vendimmarrëse, të cilat prezumohen se lidhen drejtpërdrejtë me besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, i cili është vendosur në qendër të reformës në drejtësi, për pasojë edhe diligenca për krijimin e bindjes lidhur me nivelin e besueshmërisë për kriterin e pasurisë mund të jetë më e

¹⁸ Shih vendimet e Kolegjit nr. 13/2020 (JR) dhe nr. 8/2024 (JR).

ulët. *Parimet e Bangalores* përcaktojnë, gjithashtu, një standard më lartë për sjelljen dhe detyrimet që mbart një magjistrat, karshi një anëtari tjetër të komunitetit apo të profesionit¹⁹, e cila mund të indikojë për një standard të ndryshëm edhe në matjet që bëhen për këtë kategori subjektsh në raport me magjistratët. Në konsideratë të këtij parimi, mbahet në vëmendje se subjekti nuk ka ushtruar asnjëherë funksionet e magjistratit dhe gjithashtu ka ushtruar funksionet e ndihmëses ligjore për një periudhë të shkurtër kohore, prej qershorit 2015.

19.9. *Së teti*, në përmbyllje të gjithë argumenteve si më lart, trupi gjykues vlerëson se dhënia përparësi e një balance negative, pa konsideruar të gjithë faktorët e tjerë të renditur më lart, nuk do të ishte në përputhje me qëllimin e procesit të rivlerësimit dhe përmbushje me përgjegjshmëri e detyrës prej institucioneve të rivlerësimit, Kolegjit në këtë rast, sikundër në kryerjen e procesit për çdo subjekt rivlerësimi. Parimi i objektivitetit, në rastin konkret, tregon se balanca negative nuk i dedikohet sjelljes me faj apo keqbesim të subjektit, por rrethanave jetësore nëpër të cilat ka kaluar ajo dhe familja e saj. Në vijim, trupi gjykues, në zbatim të parimit të proporcionalitetit, vlerësoi balancën negative të rezultuar për arsyet e sipërpërmendura, që i përket periudhës përpara se subjekti i rivlerësimit të emërohej në detyrën e ndihmëses ligjore, e në ushtrim të së cilës edhe në të ardhmen nuk do të ushtrojë funksione vendimmarrëse, por këshillimore, në ndryshim nga vlerësimi i bërë situatave të ngjashme për subjektet të tjerë të rivlerësimit, të cilët kishin statusin e magjistratit apo ishin kandidatë për të pasur atë.

19.10. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në konkluzionin se balanca negative prej (-) 8.188.234 lekësh para marrjes së detyrës prej subjektit dhe prej (-) 546.547 lekësh pas marrjes së detyrës, nuk duhet të penalizojnë subjektin e rivlerësimit, për vijimin e ushtrimit të detyrës prej saj. Pavarësisht ekzistencës së kësaj balance, trupi gjykues vlerësoi se subjekti arrin nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë në një matje diskrecionare që i bëhet kësaj besueshmërie, që në rastin konkret, shkon në këtë konkluzion. Nën këtë optikë, ankimi i Komisioneres Publike, lidhur me këtë çështje, vlerësohet se nuk ka marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e rastit, sipas parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, të cilat shkaktojnë në rastin objekt gjykimi pengesa të arsyeshme për ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit.

- 20.** Për sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, në konsideratë edhe të konkluzioneve të Komisionit se subjekti ka rezultuar me nivel të besueshëm në drejtim të kriterit të kontrollit të figurës dhe të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arriti në përfundimin se vendimi i Komisionit, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Albana Palaj, është i bazuar në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

¹⁹ Ndër të tjerë, referuar Rregulli 4.2. dhe paragrafit 114 të Komentarit të Parimeve të Bangalores për Sjelljen e Gjyqtarëve: “Një gjyqtar/e duhet të përgatitet të jetë objekt i kontrollit e vëzhgimit të përhershëm e komenteve publike dhe për pasojë, të pranojë kufizime të aktiviteteve të tij/saj që mund t’i duken barrë një qytetari të zakonshëm. Gjyqtari/ja duhet ta bëjë këtë me vullnet të lirë dhe më dëshirë edhe kur këto veprime nuk do të shiheshin negativisht nëse kryhen nga anëtarë të tjerë të komunitetit apo të profesionit. Ky parim gjen zbatim qoftë në jetën profesionale, ashtu edhe në sjelljen personale të gjyqtarit/es. Ligjshmëria e sjelljes së gjyqtarit/es ndonëse me rëndësi, nuk përbën të vetmen njësi matëse të sjelljes së përshtatshme”.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 789, datë 25.07.2024, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Albana Palaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot, më datë 04.03.2026..

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi